



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 28.03.2019, e  
cila filloj në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Muhedin Nushi, nënkyetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Migjen Shala (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Uran Ismaili (PDK), Sokol Berisha (AAK), Ylli Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika (AAK), Fiknate Bejtë (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA), dhe Baton Dushi (Nisma).

**Munguan:** Besnik Mujeci (LVV) dhe Visare Gashi (PSD).

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit. Ai hapi diskutimin rrëth rendit të ditës.

**Mirsad Vitia** tha se po bëhen tash e një kohë që disa nga kolegët tanë nuk e shohin të arsyeshme që të janë të rregullt në mbledhjet e Kuvendit. Qysh nga fillimi i punës së këtij Kuvendi komunal, zotëri Uran Ismalili, ministër i Shëndetësisë, më shumë ka munguar sesa që ka qenë prezent, përveç rasteve kur është dashur t'i bëjë numrat këtij ekzekutivi të dështuar. Gjithashtu, kemi harruar kur ka marrë pjese për herë të fundit në këtë Kuvend edhe znj. Visare Gorani - Gashi, e partisë së kryetarit në mungesë. I bëjmë thirrje kryesuesit, që në përputhje me ligjin dhe rregulloret në fuqi, e mbi të gjitha në përputhje me etikën e punës, të ndërmarrë këta hapa:

1. T'i kryejë obligimet e veta në përputhje me ligjin dhe rregulloret në fuqi dhe të vendosë interesin qytetar mbi të gjitha, pasi që përgjegjësia e tij dhe përshkrimi i detyrave të tij janë në këtë funksion;
2. Nëse ka arsyetime për këto mungesa, t'i bëj publikë ato dhe të shohim se çfarë qenka më e rëndësishme sesa përfaqësimi i qytetarëve në Prishtinë dhe problemet që ka kryeqyteti;
3. Të marrë masa që sa më shpejt dhe në përputhje të plotë me Ligjin për vetëqeverisje lokale, t'u merret mandati të gjithë atyre që nuk i respektojnë këto rregulla.

**Shefqet Osmani** kërkoi nga kryesuesi që të njoftohen anëtarët e Kuvendit rrëth disa ndryshimeve të emërtimeve të reja në drejtoritë e Komunës.

**Muhedin Nushi**, nënkryetar, tha se znj. Medina Braha është emëruar drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se para tre muajve është kërkuar votimi dhe kthimi i Pallatit të Rinisë nga menaxhimi i AKP-së në menaxhim të Komunës së Prishtinës. Me gjithë dilemat, Kuvendi ka votuar për kthimin e Pallatit të Rinisë në menaxhim të Komunës. Katër muaj pas vendimit të marrjes për menaxhim të Pallatit të Rinisë nga Komuna e Prishtinës, 102 punëtorë të Pallatit të Rinisë nuk kanë marrë paga e tyre që iu takojnë dhe si pasojë e kësaj, këta punëtorë janë në greva dhe janë pezulluar aktivitetet sportive dhe rinore në Pallatin e Rinisë. Pse ka ardhur kjo situatë, si është gjendja e Pallatit të Rinisë dhe si është menduar të dilet nga kjo situatë? Ne e dimë që Pallati i Rinisë ka pasur probleme, ka mundur me u menaxhuar më mirë, e jo të mbesin punëtorët pa paga për katër muaj. Për këtë arsy po kërkoj që kjo të futet për diskutim në rendin e ditës.

**Kryesuesi** tha se nesër e kemi seancën e jashtëzakonshme, ku bëhet bartja e buxhetit, e që është paraparë bartja edhe e atyre mjeteve që parashihen për Pallatin e Rinisë.

**Agim Gashi** shprehu mendimin se kalimi i ish-drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike në detyrë të re, në pozitën e drejtorit në ndërmarrje komunale, paraqet konflikt interes, nëse nuk janë përfillur procedurat ligjore, dm.th. dhënia e dorëheqjes paraprake me rastin e konkurrimit.

**Shefqet Osmani**, në cilësinë e anëtarit në Komisionit komunal të aksionarëve të Pallatit të Rinisë, tha se nuk është e vërtetë që punëtorët nuk kanë marrë pagë që katër muaj, por vetëm pagën e muajit shkurt, vetëm për një pagë kemi obligim. Problemet me Pallatin ne i kemi trashëguar, nuk i kemi krijuar, por problemi me bartje të mjeteve është diçka tjeter, andaj shpresoj që shumë shpejt do të përfundojë edhe ajo procedurë

dhe shpresoj që Pallati do të jetë një ndërmarrje, me të cilën do të krenohet Prishtina dhe do t'i sjellë të hyra më së shumti Komunës së Prishtinës.  
Eman Rahmani u shpreh në mbështetje të kërkesës për diskutim rreth gjendjes në Pallatin e Rinisë dhe të informimit më detaj për këtë ndërmarrje.  
Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e z. Retkoceri: "Diskutim për gjendjes në ndërmarrjen publike lokale "Pallati i Rinisë"".

**Kryesuesi konstatoi se më 12 vota për, 22 kundër dhe 4 abstenime, nuk u miratua propozimin i dhënë nga z. Leutrim Retkoceri.**

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës.

**Kryesuesi konstatoi se më 38 vota për dhe 1 abstenim, u miratua ky**

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në mes të Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës dhe Komunës së Prishtinës;
3. Propozimvendimi për dhënien e autorizimit Kryetarit të Komunës për inicimin e procedurave për kthimin e ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" nga AKP në ndërmarrje publike lokale;
4. Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të Projektdokumentit për revidimin e Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje";
5. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim NPL "Hortikultura", SHA, në Prishtinë;
6. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për transparencë;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri Hoxhës dhe Besnik Asllanit;
8. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit kushtuar të vrarëve prishtinas në pesëvjeçarin e parë pas luftës së dytë botërore;
9. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore kushtuar viktimate të luftës së vitit 1999 të lagjes "Sofalia";
10. Pyetje dhe përgjigje;
11. Të ndryshme.

## Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 39 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

## Pika e dytë

Propozimvendimi për nisjen e bashkëpunimit ndërkomunal në mes të Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës dhe Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi hapi diskutimin.

**Shefki Gashi** tha se në këtë marrëveshje do të ishte mirë që të përcaktohej edhe mirëmbajtja e rrugëve dhe nëse ajo parashihet si regionale, të lidhet me fshatrat. Meqë është marrëveshje mes 4 komunave, është mirë që secila komunë me e mirëmbajtur pjesën e vetë qoftë atë dimërore, qoftë infrastrukturore.

**Leutrim Retkoceri**, bëri vërejtje në nenin 2 të Memorandumit, duke thënë se emri Lupçë është shkruar gabim (Lupçë), andaj duhet të përmirësohet, të shkruhet Lupçë i Poshtëm. **Muhedin Nushi**, nënkyetar, tha se Komuna e Obiliqit është lider, kurse komunat tjera janë pjesëmarrëse, dhe komuna lider i udhëheqë të gjitha procedurat e prokurimit. **Donacioni** në vlerën prej 1 milion euro, vjen nga USAID dhe patjetër do të jetë e përfshirë edhe mirëmbajtja e rrugëve.

Kryesuesi konstatoi se më 40 vota për, 1 abstenim, u miratua Vendimi për nisjen e bashkëpunimit ndërkomunal në mes të Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës dhe Komunës së Prishtinës.

## Pika e tretë

Propozimvendimi për dhënien e autorizimit Kryetarit të Komunës për inicimin e procedurave për kthimin e ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" nga AKP-ja në ndërmarrje publike lokale.

Kryesuesi hapi diskutimin.

**Halim Halimi** tha se me rastin e kthimit të ndërmarrjeve shoqërore "Tregjet" në atë lokale, a i merr edhe obligimet Komuna, apo është pa obligime. Lidhur me këtë do të duhej të kishim një arsyetim të shkurtër.

**Genc Bashota**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, tha se ndërmarrja nuk ka kurrfarë borxhi, por zyrtarisht nuk kemi ende një bilanc.

**Eman Rrahmani**, tha se do të ishte shumë më efektive ta propozojmë dhe ta votojmë si propozim, që në negociata të jetë Selim Pacolli, nënkyetar i Komunës, ku do ta përfaqësonte edhe në njëfarë mënyre Kuvendin, për shkak se Kuvendi është ai që e kthen ndërmarrjen në kuadër të Komunës, pasi që kryetari në secilën negociatë ka dështuar.

**Halim Halimi** tha se ne po e autorizojmë kryetarin, e ai asnjëherë nuk është në mbledhje. Ne duhet të informohemi se a ka obligime ajo ndërmarrje apo nuk ka. Ne e dimë që ka ngarkesa, ka qira mbi qira, unë mendoj që kanë me lindur probleme financiare, andaj ka qenë mirë me u ditur pozicioni i kryetarit, ai është kompetent me folur për këto.

**Ardian Olluri**, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, tha se këtu në fakt po kërkohet që kryetari, i cili e përfaqëson Komunën e Prishtinës, me i kërkuar Qeverisë me i filluar procedurat për kthimin e një ndërmarrje shoqërore në një ndërmarrje komunale, pra kjo nënkuption që nëse Kuvendi e jep autorizimin, kryetari i bënë kërkesë Qeverisë dhe Qeveria e dorëzon propozimin në Kuvend të Republikës.

**Kryesuesi** tha se këtu po votohet me iniciuar procedurën, gjegjësisht me bërë kërkesën kush është i autorizuar për këtë çështje. Pra, për këtë është i autorizuar Kryetari i Komunës dhe ai ka të drejtë me autorizuar dikë tjetër. Nuk mundemi ne si Kuvend me zgjedhur kush ka me qenë i autorizuar për me shkua në Qeveri.

**Leutrim Retkoceri** tha se një vendim i tillë mundet me u përsëritur prapë, sepse ne nuk po marrim as sqarimet, e as nuk po i kemi aktet relevante për me i diskutuar këto çështje. Pjetjet që ne mundemi me i ngritur, që janë të shumta, pra a ka obligime ndërmarrja "Tregjet", a ka punëtorë, çfarë kapitali jemi duke e marrë dhe me çfarë obligimesh po ngarkohemi. Pra, nuk besoj që sot mundet Genci, drejtori, me na u përgjigjur, por një dihet, se ato biznese që kanë operuar nëpër vendet ku i ka lokalet ndërmarrja "Tregjet", në shumë kontrata kush i definon, kush i merr përsipër ato prapë. Ky autorizim mundet me u bërë, po çka më pas!?

**Shefqet Osmani** theksoi se sa i përket inicimit të procedurës për kthimin e ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" nga AKP-ja në ndërmarrje publike lokale, ky problem është i qeverisjes komunale, mirëpo ne e kemi pranuar ndërmarrjen me ato obligime që kanë qenë.

**Shefki Gashi** tha se brenda 4 muajve e kemi dështimin e parë që e kemi bërë në këtë formë pa një elaborat, pa një raport, pa një grup punues, i cili kish me i bërë analizat që me i pa të gjitha të metat juridike dhe fizike të ndërmarrjeve që duam me i kthyer në Komunën e Prishtinës. Tregu është, sidomos tregu i madh, është një industri, atje zhvillohet një industri, nuk është punë e vogël. Gjendja e tregjeve në Prishtinë është e tmerrshme. Te gjitha tregjet, qoftë ai i Llabjanit, është me mijëra herë më i mirë se tregu i Prishtinës, po ashtu edhe tregu i Lipjanit, pra qytetet tjera i kanë tregjet më të mira shumë sesa tregjet e Prishtinës. Ne duhet me ditur ekipin, duhet me ditur ekspertët, duhet me ditur projektin, vardin ku ka me u ndarë për tregun. Pra, ne dëshirojmë që kur të votojmë, me ditur çka po votojmë, mos me rënë në pozita qesharake edhe pozita tjera të dëmshme për palët tjera të përfshira.

**Adian Olluri** u shpreh se nëse Kuvendi e miraton këtë propozim, në Kuvend sillet komplet materiali, me të gjitha dokumentet e nevojshme, të gjitha pasqyrat, edhe merret autorizimi final i këtij Kuvendi për me u regjistrua ajo ndërmarrje si ndërmarrje komunale. Sot nuk mundet me u dorëzua një material i tillë, sepse nuk kemi autorizim as prej AKP-ës, as prej kurkujt me i kërkuar pasqyrat, dokumentet etj.

**Fikneta Bejta** tha se ne këtu jemi duke folur për të marrë në menaxhim një ndërmarrje që e menaxhon AKP-ja. Ka pasur shumë raste që Komuna e Prishtinës është akuzuar për keq menaxhimin e tregjeve dhe pamjen katastrofale, mirëpo kemi bërë akuza të padrejta, sepse Komuna nuk ka pasur autorizim as me i rinovuar, as me investuar, as me menaxhuar. Sa i përket peshës se kreditorëve të mundshëm, ne duhet bërë një balancë se a është e rëndësishme që Tregu me iu kthyer Komunës si aset i saj, me menaxhuar Komuna me "Tregjet", apo me lënë si të tillë me privatizuar. Faktikisht, nëse vazhdon me u menaxhuar nga AKP-ja, tregjet dikur kanë me dalë në privatizim. Është shumë e rëndësishme tregu me iu kthyer në menaxhim Komunës, edhe përkundër faktit që është e mundshme me pasur një numër të madh të kreditorëve ose borxhlinjve. Sa i përket aspekti financiar, duhet ta kemi të qartë se politikat menaxheriale të AKP-së nuk lejojnë që pasqyrat financiare të asnë ndërmarrje të jenë publike.

**Egzon Azemi**, lidhur me tregjet, u shpreh se mjafton vetëm me shkuar me vizituar tregun që e kemi këtu afér Komunës dhe me biseduar me cilindo prej atyre tregtarëve. E di që është folur shumë për premtimet e shumta qe u kanë bërë këto dy vitet e fundit, sidomos edhe për punët konkrete që janë realizua, në fakt puna është zero. Ai treg është sikur me qenë në Mesjetë, me shumë mbeturina, me një gjendje të tmerrshme, kështu që ne do ta përkrahim themelin e një ndërmarrje për tregjet, mirëpo nëse vazhdon edhe kjo ndërmarrje ashtu siç po menaxhohen ndërmarrjet tjera, po e dimë qysh tash rezultatin final.

**Rifat Deri** tha se propozimi për dhënen e autorizimit kryetarit për iniciimin e procedurave për kthimin e ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" nga AKP-ja në NPL, është shumë i qartë. Pra, a po dëshirojmë me ia dhënë autorizimin kryetarit me biseduar me AKP-në për rikthimin e tregjeve në menaxhim të Komunës së Prishtinës?

**Migjen Shala** shprehu mendimin se ka qenë më se e domosdoshme që për këtë pikë që po diskutohet, me qenë i pranishëm edhe kryetari. Ai është dashur t'iu drejtohet anëtarëve të Kuvendit se çka po kërkon, çka e ka ndërmend me bërë, për atë arsyе ne votojmë, përndryshe personalisht unë nuk votoj kurrë për këtë.

**Nol Nushi** theksoi se normalisht që Kuvendi i Komunës duhet me autorizuar kryetarin, pra Komuna duhet me i marrë tregjet, edhe në qoftë se kanë shuma të mëdha borxhesh dhe Komuna ka për obligim me e ndihmuar qytetarin, e jo me ikur prej përgjegjësisë. Ne e dimë mirë se si menaxhohen ndërmarrjet publike, andaj është e pakuptimtë të sillemi në këtë mënyrë.

**Sami Boroci** u shpreh se personalisht mendoj që duhet me ia dhënë autorizimin kryetarit. Nëse vjen prapë në Kuvend për të kaluar në ndërmarrje lokale me u votuar prapë, deri atëherë ne do të kemi edhe pasqyra të qarta se a ka obligime, çfarë obligimesh ka, në çfarë gjendje janë, dhe nuk po e shoh shumë të arsyeshme me e bllokuar në këtë fazë. Ne si grup jemi pro votimit.

**Fatos Dibra**, përfaqësues i Zyrës ligjore, tha se fillimi shka me u bërë një kërkesë prej kryetarit dhe pas kërkesës së kryetarit, Qeveria e dërgon në Kuvend të Republikës së Kosovës. Kuvendi duhet ta votojë dhe në fund bëhet një marrëveshje, pastaj sillet në Kuvend, ku dhe do të shihen se cilat janë borxhet dhe të hyrat.

**Kryesuesi konstatoi se më 36 vota për, 5 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për dhënien e autorizimit Kryetarit të Komunës për iniciimin e procedurave për kthimin e ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" nga AKP-ja në ndërmarrje publike lokale.**

#### **Pika e katërt**

**Propozimvendimi për lénie në shqyrtim publik të Projektdokumentet për revidimin e Planit rregullues të hollësishëm për tëresinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje".**

**Genc Bashota**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe zhvillimit të Qëndrueshëm, tha se ky Plan rregullues "Prishtina e Re - Zona Lindje", ka kaluar në këtë asamble në vitin 2017. Në prill të vitit 2018, Qeveria e ka nxjerrë një vendim për zonën e interesit të veçantë në këtë pjesë ku shtrihet ky plan. Me këtë revidim të këtij plani nuk ka kurrfarë lëvizje të koeficienteve, mbesin ato që kanë qenë të propozuara më herët. Të gjitha hapësirat publike dhe të gjelbra, janë të trajtuarë ashtu si kanë qenë më herët, do të thotë është vetëm konvertim me një situatë karshi rrëthanave tjera që i ka bërë Qeveria. **Eman Rrahmani** tha se procedurat tejet të zgjatura rrëth miratimit të këtyre planeve po i dëmtojnë qytetarët, për shkak se po e pengojnë procesin e Hartës zonale dhe Planit zhvillimor. Na është thënë se për secilin plan që është ardhur, diku përafërsisht do të përfundojë për 3 deri në 4 muaj, mirëpo e vërteta është që planet e hollësishme nuk mund të përfundojnë së paku pa 6 ose 7 muaj, për shkak të procedurave dhe dëgjimeve publike që duhet me u bërë.

Ai kërkoi që ekzekutivi të merret më seriozisht me Hartën zonale dhe Planin zhvillimor dhe t'i përfundojë këto procese dhe bllokime të qytetarëve.

**Halim Halimi** theksoi se edhe në të kaluarën këto plane rregulluese kur i kemi marrë me shumicë votash, të gjitha janë kthyer prej Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si të kundërligjshme, sepse nuk janë në harmoni me Ligjin mbi planifikimin hapësinor. Do të duhej që së pari të bëhet Harta zonale, pastaj të bëhen planet rregulluese të hollësishme ose revidimi i tyre.

**Nol Nushi**, lidhur me konfirmimin e ligjshmërisë rrëth këtyre planeve, tha se është një instancë tjetër Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, që na e kthen konfirmimin e ligjshmërisë së vendimeve tona. Pra, derisa të gjitha këto vendime që i kemi marrë jemi në rregull me ligjin, nuk kemi arsyë mos me i votuar këto. Pajtohem që këto nuk bën me qenë në kundërthënie me planifikimin e Hartës zonale.

**Agim Gashi** tha se në çoftë se i shohim përbajtjet e ligjeve, vërtetë ka dilema të mëdha, sepse nuk i kanë sqaruar me akte nënligjore. Kur trajtohet një segment, një problem e trajton qartë, për këtë nxirret ai akt edhe nuk lihet hapësira për interpretim ligjor. Ne të gjithë po e dimë që ka një mungesë këtu shumë serioze, që nuk na bënë të ndjehemi si shtet i mirëfilltë.

**Ardian Olluri**, drejtor, tha se është e vërtetë që Harta zonale nuk është bërë, por nuk është bërë kurkund në Kosovë, as në komuna të vogla, s'është bërë as prej Qeverisë. Kjo është bërë sepse nga Ligji i planifikimit është ndryshuar komplet dokumentacioni, pra është ndryshuar ligji edhe është paraparë ndryshimi komplet i dokumenteve të

planifikimit, pa i vlerësuar saktë edhe buxhetin, edhe burimet njerëzore, për me i bërë këto ndryshime. Ka qenë vendimi, ku Kuvendi e ka autorizuar ekzekutivin me e bërë hartimin e planit dhe Zyra ligjore ka dhënë një interpretim që është e ligjshme, edhe nuk ka ardhur asnjë akt për atë vendim prej Ministrisë që thotë se është e paligjshme, pra konfirmimi i ligjshmërisë është bërë në heshtje.

**Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, 3 kundër dhe 11 abstenime, u miratua Vendimi për lënie në shqyrtim publik për dokumentet për revidimin e Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje".**

**Pika e pestë**

**Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim NPL "Hortikultura", SHA, në Prishtinë.**

**Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, 2 kundër dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim NPL " Hortikultura", SHA, në Prishtinë.**

**Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për transparencë.**

**Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për miratimin e Planit të veprimit për transparencë.**

**Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri Hoxhës dhe Besnik Asllanit.**

**Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri Hoxhës dhe Besnik Asllanit.**

**Pika e tetë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit kushtuar të vrarëve prishtinas në pesëvjeçarin e parë pas Luftës së Dytë Botërore.**

Rifat Deri tha se shumë ngjarje të ndodhura në Prishtinë, sidomos ato të viteve 1945 – 1966, kishin të bënин me vrasjet, krimet e shumta nga sistemi ose diskriminimi, shantazhimi, shpërnguljet dhe vendimet e padrejtë politike, ku për vite të tëra kumbuan aktivisht, por vetëm brenda memories kolektive të Prishtinës dhe prishtinasve.

Për fatin e keq të prishtinasve dhe të të gjithë atyre që pësuan aso kohe, jo pak ngjarje të këtilla që ndodhën në Prishtinë sikurse i mbuloi pluhuri i harresës. Ky pluhur nuk i bën nder as Prishtinës, as Kosovës.

Për të gjithë banorët e Prishtinës dhe rrithinës së saj që u vranë në dy dekadat pas Luftës së Dytë Botërore, konkretisht në vitin 1945-46-47, respektivisht për veprimtarët e çështjes kombëtare që u pushkatuan nga regjimi i atëhershëm në vendin që nga prishtinasit njihet si Strelishte, afër parkut të sotëm Taukbahçe në Prishtinë. Propozoj që në këtë vend nga Komuna e Prishtinës të ngrihet një përmendore ose lapidar, në shenjë respekti dhe kujtimi për veprimitarët patriotike të njerëzve që u flijuan për këtë qytet dhe për lirinë e vendit tonë.

**Shefki Gashi** u shpreh në përkrahje të propozimit të z. Deri, por ka edhe mjaft emra të cilët nuk po figurojnë këtu në këtë listë, duke filluar prej Xhon Sereqit, Azem Bellaqevcit, Haki Rimanishtës, Shemsi Hazirit e të tjerë. Njëri nga të pushkatuarit në këtë vend në vitin 1947 është edhe axha im, por ka edhe shumë të tjerë. Një propozim të tillë e kemi dhënë në Kuvend në vitin 2000, por zëvendës administratori i atëhershëm nuk na ka lejuar me e vendosur një lapidar të tillë. Si grup parlamentar, këtë propozimvendim ne do ta votojmë për miratim.

**Vlora Dumoshi** tha se ky propozim i z. Deri është i qëlluar, sepse vërtet Prishtina ka një histori, ku njerëzit tanë, gjyshërit tanë, familjarët i kemi aty të pushkatuar. Tash ndoshta një pjesë e madhe e familjeve të cilat janë pushkatuar nuk janë fare në Prishtinë, sepse ata pastaj pësuan edhe tragjedinë e dytë të përzëniajshme për në Turqi dhe vende të tjera. Por, duhet të shohim edhe në arkivat, të cilat nuk janë hapur një pjesë e madhe, dhe t'i kemi emrat e saktë të njerëzve të cilët kanë mbetur në atë gropë të pushkatimit nga dora e serbëve.

Andaj, për mua është me rëndësi jo vetëm me e bërë një përmendore, por me qenë një vend referues edhe për qytetin e Prishtinës, për memorien e Prishtinës, për historinë e Prishtinës, kështu që e falënderoj shumë për këtë iniciativë dhe e përkrahim në çdo moment.

**Sami Boroci**, sa i përket këtij propozimi, shpreh mendimin se duhet me u diskutuar edhe me Drejtoren e Kulturës edhe më shumë aktorë të kësaj fushe në Prishtinë, në mënyrë që ndoshta ne me u orientuar nga krijimi i muzeve, apo caktimi i hapësirave të caktuara, që janë vendet potencialisht të rekomanduara edhe për vizitorë, e jo me përfunduar vetëm në disa lapidare. Mendoj se ndoshta për të ardhmen diskutimin duhet me orientuar drejt krijimit të hapësirave të muzeve, ndoshta disa muze më të vogla, mirëpo që e pasqyrojnë një pjesë të historisë së Prishtinës.

**Vala Peshku** tha se edhe ne jemi për ngritjen e këtij lapidari edhe pikës së ardhshme, që është pllaka përkujtimore. Unë po e shoh disponimin e kolegëve sot për një qasje që e kam ngritur në fakt në KPF herën e kaluar, e që ka pasur të bëj vetëm rrith estetikës ose vlerës kulturore, apo dizajnit të këtyre gjërave të lapidarëve apo pllakave përkujtimore.

**Egzon Azemi** tha se në raste të tilla kur propozohet ngritja e një lapidari për ngjarje historike, atëherë normalisht se ishte dashur një komisioni, të cilin do ta përfaqësonin historianë, arkitektë dhe dizajnerë që merren me këto çështje dhe i dinë pak më shumë detajet e këtyre çështjeve. Këto detaje estetike tek këto vepra, po i shohim kur po është puna tek ndonjë monument shqiptar, sepse kur po na vijnë këtu propozimet nga KFOR-i në këtë rast, ose nga dikush tjetër, asnjë pyetje nuk ngrihet në këtë drejtim dhe votohet pa marrë parasysh se çfarë lapidari, çfarë pamje

ka dhe në çfarë vendi kërkuhet. Kam kërkuar që mos t'i kemi dy standarde në këtë çështje.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 39 vota për, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit të të vrarëve Prishtinas në pesë vjeçarin e parë pas Luftës së Dytë Botërore.**

**Pika e nëntë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore kushtuar viktimate të luftës së vitit 1999 të lagjes Sofalia.**

**Kryesuesi konstatoi se më 38 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore kushtuar viktimate të luftës së vitit 1999 të lagjes Sofalia.**

**Pika e dhjetë**

**Pyetje dhe përgjigje**

**Egzon Azemi, për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:**

- Në komunën e Prizrenit gjatë vizitave sistematike te shkollat filllore, kanë dalë diku se gjatë këtij viti mungojnë në proceset mësimore rrith dy mijë nxënës, që i bie kryesisht shumica prej tyre së bashku me familjet e tyre kanë dalë jashtë vendit. A ka filluar Komuna e Prishtinës, pikërisht drejtoria e Arsimit, në ketë proces që me i identifikua gjatë këtij viti shkollorë sa nxënës më pak e kanë përfunduar vitin dhe sa e kane nisur në fillim.
- Në lagjen "Medrese" prania e marketit "Viva Fresh" po shkakton një pengesë të madhe në komunikacion, pasi që aty është rruga shumë e ngushtë dhe trotuaret janë të ngushta edhe veturnat që parkohen për të kryer shërbime aty, kombit e kamionetat që ndalojnë aty për të bartur mallra, po iu krijon shumë vështirësi banoreve të asaj zone. Kërkoj nga drejtoria përkatëse që të marrë masa për zgjidhjen e këtij problemi.

**Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, tha se në komunën e Prishtinës veç po rritet numri i nxënësve, duke e pasur parasysh ardhjen e banorëve nga komunat tjera. Në fund të gjysmëvjetorit sigurisht që do ta kemi një pasqyrën të saktë.**

**Adonis Tahiri, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, tha se është në hartim e sipër një projektrregulllore, përmes së cilës i caktojmë oraret e furnizimit për secilin market, edhe për "Viva Fresh", në mënyrë që gjatë ditës mos me u lejuar me u bërë furnizim as nëpër kafeteri, as nëpër markete.**

**Kushtrim Sopa, për Selim Pacolli, nënkyrjetar i Komunës, për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:**

- Çfarë po ndodh me lokalet e NPB-së që gjinden tek lokacioni "Te plepat" aty ku tash është AKP-ja, a do të jepet për partneritet publiko-privat dhe nëse po, atëherë kur dhe si do te jepet?
- A do të merren masa nga Komuna e Prishtinës për përmirësimin e gjendjes së ndriçimit në parqet e komunës së Prishtinës, me theks të veçantë në parkun e lagjes "Arbëria"?
- Pranë shkollës "Mehmet Gjevori", në lagjen "Arbëria", kemi pusetë të hapur, e cila për momentin është e mbuluar me shkurre, me ç'rast kërkojmë nga organet kompetente të merren masë emergjente lidhur me ketë rast, për shkak që kanoset siguria e nxënësve, fëmijëve dhe qytetarëve që e shfrytëzojnë këtë rrugë për arsyet e veta personale dhe kolektive. Gjithashtu, rruga "Plava", e cila lidh lagjen "Arbëria" te Xhamia e Arbërisë me lagjen "Shkabaj", në shumë raste pusetat në këtë rrugë vidhen apo hiqen me qëllime të këqija. Ju njoftoj se rreziqet për aksidente me përmasa të mëdha janë evidente çdo ditë, andaj ju ftoj të mermi masa emergjente;
- Rregullimi i infrastrukturës rrugore në lagjet "Tophane" dhe "Qafa", sepse nevoja për përmirësimin e gjendjes aktuale është evidente dhe tejet e nevojshme;
- A do të shtrohet rruga "Sharri" me infrastrukturën e nevojshme?
- Kur do të përfundojnë punimet e shkallëve në lagjen "Arbëria", të cilat tani më i kanë kaluar të gjitha afatet e parapara për përfundimin e punëve?
- A do të rinovalohen fushat dhe hapësirat ekzistuese sportive dhe rekreative në qytetin tonë dhe kur?

**Shefqet Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:**

- Kërkoj të dijë se për punimet të cilat po i zhvillon KEDS-i, ekskluzivisht në lagjen "Kodrën e Trimave", a kanë leje. Ata qe dy vjet jo që e kanë shkatërruar infrastrukturën rrugore të lagjes "Kodra e Trimave" po e bëjnë edhe një eksperiment, të cilën mendoj se në heshtje Komuna nuk është duke e vërejtur. Ata janë duke i usurpuar hapësirat komunale në trotuare me vendosjen e atyre orëmatësve për secilën shtëpi. Për mendimin tim, ky është usurpim i pronës komunale dhe një shqetësim shume i madh.

**Adonis Tahiri, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, tha se KEDS-i për punët të cilat i bën, ka leje, por jo vetëm me KEDS-in, por edhe me ndërmarrjet tona komunale, siç janë "Termokos", ujësjellësi "Prishtina", ku jemi edhe ne pjesë e tyre, që po shkaktojnë shumë dame infrastrukturore dhe nuk po e kthejnë në gjendjen e mëparshme. Nga muaji i kaluar, kemi fillua me i dënuar edhe ndërmarrjet tona, edhe KEDS-in, dhe gjendja tash është pak më e mirë dhe jemi duke i obliguar me e kthyer terrenin në gjendjen e mëparshme.**

**Vjosa Hamiti-Krasniqi, për drejtorin e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale:**

- A janë duke u shpërndarë fondet për familjet që janë në gjendje të rëndë sociale?

**Mirsad Vitia, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës:**

- Banorët e lagjes së Hajvalisë kërkojnë renovimin - përmirësimi e trotuarit në rrugën

Kryesore, rruga "Dëshmorët e Gollakut", nga të dy anët e rrugës, si dhe mundësishët të vihen shtylla anti-parking, në mënyrë që makinat të mos jenë pengesë për këmbësorët.

- Po ashtu, kërkojnë rregullimin e një parku apo këndi sportiv, në vendin ku ndodhet Shtëpia e kulturës, e cila tanimë është në gjendje të mjerueshme, ose përreth ku Komuna ka tokë, ka hapësirë të mjaftueshme për një gjë të tillë. Edhe pse do të ishte më së miri sikur Komuna të ndërtonte Shtëpinë e kulturës, siç ka qenë gjithë herë. (Kërkesat janë paraqitur edhe në mënyrë grafike, vendet se ku duhet të intervenohet në sanimin e gjendjes).

**Naime Osmani, për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Udhëtarët të cilët udhëtojnë me autobus në linjën 3, kërkojnë që të vendoset një stacion i autobusëve diku në mes stacioneve te Qafa dhe te Xhamia e Llapit, pasi që deri te Xhamia e Llapit nuk ka stacion për ndalje.
- Të bëhet sinjalizimi i rrugës "Fahri Fazliu", te Kodra e Trimave, duke u përfshirë deri ne Teneshdoll, si dhe të vendosen stacione të autobusëve, sepse autobusët janë duke u ndalur vend e pa vend dhe është duke u rrezikuarjeta e qytetareve.
- Banorët afër rrugës "Naser Krasniqi" kërkojnë që të bëhet ndriçimi i asaj rruge, sepse po rrezikohen fëmijët nga qentë endacakë.

**Leonora Shabani-Bajraktari, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitele dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Banorët afër rrugës "Mustafa Kruja" kërkojnë që të rregullohet kjo rrugë, pasi që ajo është e dëmtuar tërësisht.
- Gjithashtu, qytetarët që janë afër parkut te Varrezat e dëshmorëve, si dhe te varri i Ibrahim Rugovës, kërkojnë ndriçimin e asaj hapësire, sepse janë të rrezikuar prej qenve endacakë. Po ashtu, kanë kërkuar rregullimin e trotuarit të rrugës "Rrustem Statovci". Gjithashtu, te oborri i shkollës "Ilira", pas punimeve që janë bërë aty, dheu ka mbetur ashtu tash e një vit dhe prindërit e kanë shpreh shqetësim për këtë oborr.

**Haki Dragusha, për kryesuesin e Kuvendit:**

- A do të bëhet ristrukturimi i komiteteve, sepse disa nga anëtarët kanë kaluar prej një partie në një parti tjeter, edhe tash aty po mbivotohet komiteti?
- A ka mundësi të pajisen me laptop të gjithë këshilltarët dhe drejtorët?

Kryesuesi tha se sa i përket komiteteve, tash me Udhëzimin administrativ prej Ministrisë do të reformohen thuajse të gjitha komitetet. Sa i përket pajisjes me laptop, kjo çështje është në procedurë të tenderimit.

Mbledhja mbaroi në orën 12:15

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

Faqe 12 nga 12

**Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta**

